# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-480379**

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Ergys Agasi mohon takimet me Vlora Hysenin, avokati Haxhia flet në emër të të akuzuarit nga SPAK: Sfidon këdo për ato biseda që kanë dalë… |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/29/ergys-agasi-mohon-takimet-me-vlora-hysenin-avokati-i-biznesmenit-ai-sfidon-spak-un-dhe-kedo-per-bisedat/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 29 shtator 2026, 18:55:44 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 29 shtator 2026, 18:47:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 29 shtator 2026, 18:46:00 UTC → 29 shtator 2026, 18:48:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `750a444ba1ff13d9ecab5627ef014679dabe9c55aae15bf5170eac4f6647939b` |
| TEKSTI | `e78e4cf744628d35e33d1bbfd1f3f95b554950aa27254b04c4df01443be2bb02` |
| PAMJA | `5c74033ebdda2077e4d097eaf127819a9baf8b8d565263c716316ddd4739fd3e` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `9881267a88db602d7fbecc8dc43efda4d51f6acc635320efffdb37a58f837866` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/9881267a88db602d7fbecc8dc43efda4d51f6acc635320efffdb37a58f837866`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET KRYESORE TË FUNDIT

# Ergys Agasi mohon takimet me Vlora Hysenin, avokati Haxhia flet në emër të të akuzuarit nga SPAK: Sfidon këdo për ato biseda që kanë dalë…

29/09/2026 20:47



**Ergys Agasi ka reaguar përmes avokatit të tij, Maksim Haxhia, lidhur me të dhënat dhe pretendimet e bëra publike në kuadër të hetimeve të SPAK.**

Haxhia ka përcjellë versionin e klientit të tij, duke kundërshtuar pretendimet që lidhen me takimet me ish-drejtoreshën e SHISH, Vlora Hyseni, si dhe me dokumentet që dyshohet se janë gjetur në automjetin e Agasit.

Në intervistën e dhënë për gazetaren e Top Channel, Anila Hoxha, duke folur për qëndrimin e Agasit, Haxhia deklaroi: "Po e deklaroj çfarë kam biseduar me klientin dhe më ka thënë: asnjëra nga ato nuk qëndron. Kryetarja e shërbimit informativ nuk ka qenë asnjëherë në zyrën time. Nuk e kam takuar asnjëherë, në kuptimin që të kenë takime të vazhdueshme. Se çfarë ruajnë ata në kuptimin e funksionimit të atij institucioni është tjetër gjë, këtë nuk e di…, që është një lidhje, që është aset, a është në shërbim… këtë nuk di ta them. Vetëm di të them që ai sfidon. Më ka thënë që sfidoj këdo që të thotë: "Unë kam bashkëpunuar me sekretet shtetërore" dhe e dyta: "Që në makinën që kam pasur në shtëpi janë gjetur dokumente"."

Sa i përket pretendimeve për dokumentet dhe materialet që dyshohet se janë gjetur në automjetin e Agasit, avokati ka kundërshtuar versionin e bërë publik dhe ka deklaruar se klienti i tij është i gatshëm të përballet me këto pretendime.

"Sfidon këdo për ato biseda që kanë nxjerrë në media ose në publik dhe thotë: "Po të ishin se në makinën time, që aty ka qenë, nuk ka lëvizur, se është vërtetuar që nuk është makina me të cilën është kryer rrëmbimi, të jenë gjetur materiale të shërbimit informativ". Kanë vënë në gojën e Agasit që ai ka deklaruar që: "I kam pasur këto dokumente dhe i kam lënë në makinë". Jo, nuk është e vërtetë, aty kam qenë në proces. Këtë kundërshton ai. Ai thotë, edhe prokurorinë dhe këdo tjetër që të ballafaqohet."

Haxhia ka ngritur gjithashtu pikëpyetje lidhur me publikimin e disa komunikimeve telefonike, duke argumentuar se ato, sipas tij, nuk kanë interes për hetimin. Avokati ka kërkuar që çdo material që pretendohet se ekziston të përfshihet në dosjen e hetimit, në mënyrë që mbrojtja të mund ta kundërshtojë atë në rrugë ligjore.

"Ne kërkojmë që prokuroria të distancohet, ose nëse janë të vërteta, t'i fusin në dosje, jo po të bëhet kallëzim ndaj prokurorisë. Jo, t'i vërë në dosje dhe ta bëjmë luftën ballë për ballë, pra ta bëjmë dyluftimin juridik me provat që ke, por e them përsërit, nuk besoj që prokuroria t'i ketë nxjerrë, sepse si ka, nuk i ka. …Ne, në cilësinë e mbrojtjes, na e kanë bërë mbrojtjen gati të pamundur. Ky variant fillon vazhdimisht, duke i bërë gjërat në publik, mbarset publiku dhe ne atëherë duhet të sqarojmë publikun dhe pastaj të bëjmë mbrojtjen juridike. Për mua është bërë një strategji dhe taktikë që ta vërë para fajësisë zotin Agasi."

## Kryesore



Ish-gjenerali që u bë ambasador/ Eric Wendt nis "betejën" diplomatike amerikane, zbulohet cilin takon të parin të mërkurën
19:47

Investigimi i Fiks Fare/ "Nëse Bela çon emrin…", Belinda Balluku ministre edhe pas shkarkimit. Dëshmitë ekskluzive të drejtorëve për "shefen"
07:50

Ekskluzive/ "Auditim në SHISH pas arrestit të Vlora Hysenit", zbardhen diskutimet në Këshillin e Sigurisë. Çfarë thanë kreu i SPAK dhe Kryeministri Rama
07:00

Dosja e SPAK për SHISH/ "Përgjegjësi morale dhe individuale ka", Grida Duma: Po përgjegjësinë politike kush e mban?
06:44

Tronditëse/ Ndahet papritur nga jeta ish-talenti i Anglisë dhe Manchester City-t
17:48

## Më të lexuarat

Investigimi i Fiks Fare/ "Nëse Bela çon emrin…", Belinda Balluku ministre edhe pas shkarkimit. Dëshmitë ekskluzive të drejtorëve për "shefen"

Arrestimi i Jozefin Markut, Gjykata e Apelit jep vendimin për këngëtarin

Ekskluzive/ "Auditim në SHISH pas arrestit të Vlora Hysenit", zbardhen diskutimet në Këshillin e Sigurisë. Çfarë thanë kreu i SPAK dhe Kryeministri Rama

"Nuk ekzistojnë radarët", ish-prokurori për hetimet ndaj Vlora Hysenit: Maksimumi që fikte zonja ishte fisha e përgjimit

Si u thur plani për t'i marrë 100 mijë euro Armand Dukës, zbardhen dëshmitë e dy autorëve, Balla: Më premtoi që…

Dosja e SPAK për SHISH/ "Përgjegjësi morale dhe individuale ka", Grida Duma: Po përgjegjësinë politike kush e mban?

Tha se nuk pranonte atësinë e vajzës, Katerina Goga bën deklaratën e papritur në "Ftesë në 5", zbulon mesazhin e ish-konkurrentit të "Për'puthen"

Trump lajmëroi ndalimin e eksportit të naftës drejt BE-së për 90 ditë, zyrtarët evropianë optimistë për anulimin e planit:

Morem sinjale nga...

Zbulohet ngjarja e rëndë në Vlorë, fqinji i futet të moshuarës në banesë, e godet me sëpatë në kokë dhe e përdhunon. I vjedh edhe paratë

Katastrofë ekologjike në Lushnjë/ Bashkia than rezervuarin e Kashnjetit për rikonstruksion, ngordhin tonelata peshk

Më herët, gjykata ka aprovuar tre masa të kërkuara nga SPAK për nxjerrje sekreti dhe përkrahje të autorit të krimit, mes tyre edhe për ish-kreun e SHISH, i cili mbahet në arrest shtëpiak.

Deklaratat e mësipërme përfaqësojnë qëndrimin e mbrojtjes së Ergys Agasit. Hetimet dhe pretendimet e SPAK vijojnë të jenë pjesë e procesit në zhvillim.

**Top Channel**

## Aktualitet »



Zjarr masiv në Gorishovë, flakët përfshijnë ullishtet shekullore, shoqërohet 78-vjeçari
29/09 19:57



Propozimi i Erion Veliajt për liderët e UÇK-së, miratohet nga Këshilli Bashkiak për t'u shpallur "Qytetarë Nderi" të Tiranës
29/09 18:57



Përplasi një 14-vjeçar me motor dhe u largua nga vendi i ngjarjes, arrestohet i riu në Cërrik
29/09 16:54



Zjarr në kodrën me pemëtari në fshatin Kutalli, përfshihet nga flakët një sipërfaqe e madhe me ullinj
29/09 16:09



Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, reagon Avokati i Popullit Endrit Shabani: U dha përgjigje për çdo pikëpyetjeje mbi procedurën e zgjedhjes
29/09 16:03



Kushtetuesja rrëzon kërkesën e PD-së, Endrit Shabani mbetet Avokat i Popullit
29/09 15:40

## Kryesore »



LIVE San Marino-Shqipëri/ Kërkohet fitore bindëse në transfertë, Kombëtarja me ndryshime nga mbrojtja në sulm
29/09 20:45



Shqipëria ka shansin të marrë vendin e parë në grup, rivali i drejtpërdrejt i kuqezinjve ndalet në shtëpi nga Bjellorusia
29/09 20:08



Zjarr masiv në Gorishovë, flakët përfshijnë ullishtet shekullore, shoqërohet 78-vjeçari
29/09 19:57



Lindsay Clancy akuzohet për vrasjen e 3 fëmijëve, avokati përmbys mbrojtjen në gjyq
29/09 19:52



Ish-gjenerali që u bë ambasador/ Eric Wendt nis "betejën" diplomatike amerikane, zbulohet cilin takon të parin të mërkurën
29/09 19:47



Paketë e gjerë politikash, Burnham merr vendimin për pensionet në Britani: Deri në vitin 2030...
29/09 19:24

## Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »



Top News- ‘Makina Zombi’ për të shkatërruar rusët/ Ukraina nis ofensivën e madhe në frontin e luftës



Top Channel/ Kundërshtohet ligji për kinemanë, Shanaj: Cenohen të drejtat e krijuesve



Top News- “Kujt i bërtet ti?”, prindi rreh keq drejtoreshën e kopshtit pasi i ngriti zërin fëmijës



Top Channel/ Caktohen gjyqtarët për liderët e UCK, zbulohen emrat e tre magjistratëve



Top Channel/ Siguria në shkolla bashkon 4 ministra, prezantohet paketa kombëtare



Top Channel/ Rregulla të reja në shkolla, masa kundër bullizmit dhe ekstremizmit



**© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.